




REPUBLIKA E KOSOVËS		AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGJENCIA PROTIV KORRUPCIJE		ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	DPK	Nr. Prot.	03-02/277/17
Dep.		B. Prot.	
Nr. l. faq.		Data	08-02-2017
Broj stranica	02	Datir	
Nr. pages			
PRISHTINE			



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 06.02.2017, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-02-4703/16, për z. Ardian Syla – Drejtor në Kompaninë Rajonale të Ujësjetjesit “Prishtina”, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK – 03-02-4703/16, për z. Ardian Syla – Drejtor në Kompaninë Rajonale të Ujësjetjesit “Prishtina”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Në këtë rast, zyrtari i lartë z. Syla, është hetuar për konflikt të mundshëm interesi sepse krahas ushtrimit të funksionit publik, ka qenë person i autorizuar në biznesin privat “CITY ADVERTISING” SH.P.K.

Agjencia kundër Korrupsionit ka filluar procedurën e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit në bazë të cilës ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresë zyrtare. Më pas, z. Syla është kontaktuar nga zyrtarët e Agjencisë, për t'i sqaruar situatën në të cilën ndodhet dhe për t'i dhënë rekomandimet për ndryshimet që duhet të bëj, për të shmangur situatën e konfliktit të interesit.

Ai është bindur për kufizimin e ushtrimit të funksionit menaxherial në biznesin e tij privat dhe ka pranuar rekomandimin e Agjencisë për t'u larguar nga ky funksion.

Ndërkohë, i njëjti ka dërguar në Agjenci shkresën zyrtare nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë me të cilën vërtetohet se në biznesin e tij privat ka caktuar një “person të besueshëm”, në cilësinë e personit të autorizuar, ndërsa vet ka mbetur si pronar pasiv. Me këtë ai ka shmangur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit

Shaip Havolli

